

Data 10.07.2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË PUBLIKE - Prokurim me mjete elektronike

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Përmirësimi i sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, LOTI 1 (2026)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Sinjalistikë rrugore 34992200-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 187,441,933.48 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë milion e katërqind e dyzet e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre pikë dyzet e tetë) **Lekë, pa TVSH**

Në bazë të Nenit 21, pika 2 të Ligjit Nr. 16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 Autoriteti/Enti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura e prokurimit është e parashikuar në Buxhetin e Shtetit për shpenzimet kapitale për vitet 2026-2028 (Shkresa e MIE Nr. 2741/3 prot, datë 15.04.2026).

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

- Për të provuar përvojën e mëparshme **(punë të ngjashme)**:
 - Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”
- Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale **(licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës)**:
 - Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

Argumentimi:

Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Nenit 90, pikat 5 dhe 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se për aspektet kritike të kontratës nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Duke marrë në konsideratë natyrën dhe specifikën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në realizimin e punimeve të sinjalistikës rrugore që kërkojnë njohuri teknike, organizim të përshtatshëm të punimeve, menaxhim të burimeve njerëzore dhe teknike, si dhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë për cilësinë dhe përputhshmërinë e punimeve me kërkesat e kontratës, Autoriteti Kontraktor vlerëson se disa elementë të kapacitetit të operatorit ekonomik përbëjnë aspekte kritike të kontratës.

Për këtë arsye, në zbatim të Nenit 84, pikat 6 dhe 7, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe Nenit 90, pikat 5 dhe 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar që për kriteret që lidhen me:

- **përvojën e mëparshme për realizimin e punëve të ngjashme**, sipas pikës 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”; dhe
- **përshtatshmërinë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale, përfshirë licencat profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate**, sipas pikës 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”,

operatorët ekonomikë nuk mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Ky kufizim është vendosur pasi këto elemente konsiderohen të lidhura ngushtësisht me eksperiencën, përgjegjësinë profesionale dhe aftësinë konkrete të operatorit ekonomik që do të realizojë kontratën. Përvoja e mëparshme në punime të ngjashme dhe zotërimi i licencave profesionale përkatëse garantojnë që operatori ekonomik disponon njohuritë teknike, organizative dhe profesionale të nevojshme për menaxhimin dhe realizimin e punimeve sipas standardeve të kërkuara.

Gjithashtu, duke pasur parasysh vlerën e fondit limit dhe natyrën e punimeve të parashikuara, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa është proporcionale me objektin e kontratës dhe synon garantimin e një niveli të përshtatshëm sigurie për realizimin me sukses të saj, pa cenuar parimin e konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

➤ **Në DST është përcaktuar:**

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ X

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐	pikët 60
Metodologjia ☐	pikët 5
Stafi / Organizimi i Kompanisë ☐	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social ☐	pikët 10
Periudha garancisë së objektit ☐	pikët 10

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ [kriteri 1, 5 a) dhe 5 b)] e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2, 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [60 pikë]

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 45, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar me Vendimin nr. 545, datë 04.09.2024.

Përcaktimi i çmimit si kriter vlerësimi me peshë 60 pikë është bërë duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës, objektin e prokurimit dhe rëndësinë e përdorimit me eficiencë të fondeve publike. Duke qenë se objekti i kontratës përfshin realizimin e punimeve për përmirësimin e sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore, Autoriteti Kontraktor vlerëson se çmimi përbën një element të rëndësishëm në përcaktimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, pasi ndikon drejtpërdrejt në optimizimin e kostove dhe përdorimin efektiv të buxhetit publik. Formula e përcaktuar për vlerësimin e kriterit të çmimit siguron një vlerësim proporcional ndërmjet ofertave ekonomike të paraqitura, duke i dhënë avantazh ofertës me vlerën më të ulët dhe duke ruajtur një raport të drejtë ndërmjet çmimit dhe elementëve të tjerë të vlerësimit.

Peshimi prej 60 pikësh për çmimin është përcaktuar duke mbajtur parasysh se, megjithëse çmimi është një faktor i rëndësishëm në këtë procedurë, realizimi i suksesshëm i kontratës kërkon gjithashtu përmbushjen e kërkesave teknike, disponimin e kapaciteteve profesionale, përvojën dhe organizimin e nevojshëm për zbatimin cilësor të punimeve.

Ky kriter synon të sigurojë përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme, duke garantuar njëkohësisht konkurrencë të drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe realizimin e objektit të kontratës me cilësi dhe eficiencë ekonomike.

2. Metodologjia [5 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë mënyrën që do të ndjekë kompania me kapacitetet dhe eksperiencën e saj në përmbushjen e punimeve. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm.

Faktorët favorizues: Identifikoni dhe përshkruani faktorët që do të ndikojnë pozitivisht në realizimin e punimeve. Këto mund të përfshijnë përvoja të mëparshme të suksesshme, qasje inovative, ose bashkëpunime me partnerë të besueshëm.

Pajisje inovative: Prezantoni pajisjet dhe teknologjitë e avancuara që kompania juaj do të përdorë për të përshpejtuar dhe përmirësuar cilësinë e punimeve. Kjo mund të përfshijë makineri të reja, ose metoda të reja të ndërtimit.

Metodologji punimesh: Përshkruani metodologjitë dhe proceset që do të ndiqni për të siguruar që punimet të përfundojnë në kohë dhe me cilësi të lartë. Kjo mund të përfshijë planifikim të detajuar, menaxhim të efektshëm të burimeve, dhe monitorim të vazhdueshëm të progresit.

Argumentimi:

Përcaktimi i metodologjisë së punimeve si kriter vlerësimi është bërë me qëllim vlerësimin e mënyrës së organizimit, planifikimit dhe qasjes teknike që operatori ekonomik do të ndjekë për realizimin me sukses të kontratës.

Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, realizimi cilësor i punimeve kërkon jo vetëm disponimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, por edhe një organizim të mirë të proceseve të punës, menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore dhe teknike, si dhe koordinimin e punimeve në akset rrugore ku ndërhyrjet do të realizohen.

Nëpërmjet këtij kriteri Autoriteti Kontraktor synon të vlerësojë aftësinë e operatorit ekonomik për të paraqitur një qasje të strukturuar lidhur me:

- organizimin dhe planifikimin e fazave të punimeve;
- mënyrën e menaxhimit të personelit, pajisjeve dhe materialeve;
- masat për garantimin e cilësisë së punimeve;
- mënyrat e kontrollit dhe monitorimit të progresit të punimeve;
- përdorimin e metodave dhe teknologjive të përshtatshme për realizimin e objektit.

Vlerësimi i faktorëve që lidhen me përvojën e mëparshme, pajisjet dhe teknologjitë e përdorura, si dhe metodologjinë e zbatimit, i shërben Autoritetit Kontraktor për të identifikuar nivelin e organizimit dhe aftësinë e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në mënyrë eficiente, brenda afatit të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar.

Ky kriter është proporcional me natyrën e kontratës dhe nuk synon vlerësimin e kapaciteteve minimale të operatorëve ekonomikë, të cilat verifikohen në fazën e kualifikimit, por vlerësimin e qasjes së propozuar nga operatorët për realizimin sa më efektiv të punimeve.

3. Stafi / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshtë:

- I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]
- II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]
- III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]
- IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të lëshuar nga punëdhënës të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [2 pikë]

*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjisë të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbëjnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Përcaktimi i kriterit të vlerësimit "Stafi / Organizimi i kompanisë" është bërë me qëllim vlerësimin e kapaciteteve profesionale, eksperiencës dhe mënyrës së organizimit të operatorit ekonomik për realizimin me sukses të kontratës.

Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, realizimi i punimeve kërkon jo vetëm disponimin e personelit minimal të kualifikuar si kriter kualifikimi, por edhe një organizim efektiv të burimeve njerëzore dhe një strukturë të qartë menaxhimi gjatë zbatimit të kontratës.

Nëpërmjet këtij kriteri Autoriteti Kontraktor synon të vlerësojë nivelin e ekspertizës së stafit të propozuar, përvojën e tij në realizimin e punimeve të ngjashme dhe aftësinë e operatorit ekonomik për të menaxhuar në mënyrë eficiente proceset e zbatimit të kontratës.

a) Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike [13 pikë]

Ky nën-kriter është përcaktuar për të vlerësuar nivelin profesional të stafit të propozuar për realizimin e kontratës, duke marrë në konsideratë:

- përmbushjen e kërkesave minimale të përcaktuara në kriteret e veçanta të kualifikimit;
- nivelin e kualifikimeve akademike dhe profesionale mbi kërkesat minimale;
- eksperiencën e akumuluar në vite pune;
- eksperiencën specifike në realizimin e punimeve të ngjashme me objektin e kontratës.

Vlerësimi i eksperiencës në punime të natyrës dhe kompleksitetit të ngjashëm është i rëndësishëm për shkak se punimet e sinjalistikës rrugore dhe pajisjeve të sigurisë kërkojnë njohuri specifike mbi organizimin e punimeve në akse aktive rrugore, zbatimin e standardeve teknike dhe menaxhimin e proceseve që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë rrugore.

Kërkesa për paraqitjen e CV-ve dhe dokumenteve mbështetëse nga punëdhënësit e mëparshëm ose përfituesit synon të mundësojë verifikimin e eksperiencës së deklaruar dhe të sigurojë që vlerësimi të bazohet në të dhëna të dokumentuara dhe të verifikueshme.

b) Skema e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës [2 pikë]

Ky nën-kriter është përcaktuar me qëllim vlerësimin e mënyrës se si operatori ekonomik planifikon të organizojë strukturën e tij të punës gjatë ekzekutimit të kontratës.

Paraqitja e organigramës së stafit, mënyrës së komunikimit dhe ndërveprimit ndërmjet strukturave të zbatimit, mbikëqyrësit të punimeve dhe Autoritetit Kontraktor, shërben për të vlerësuar qartësinë e përgjegjësisë dhe efektivitetin e menaxhimit të kontratës.

Avantazh do të përbëjnë strukturat e mirëpërcaktuara të kontrollit të brendshëm, procedurat e menaxhimit të cilësisë dhe mekanizmat e monitorimit të progresit të punimeve, të cilat kontribuojnë në realizimin e kontratës brenda afatit dhe me cilësinë e kërkuar.

Ky kriter është proporcional me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës dhe synon përzgjedhjen e një operatori ekonomik që, përveç përmbushjes së kërkesave minimale të kualifikimit, paraqet një organizim dhe ekspertizë më të lartë për realizimin efektiv të objektit të prokurimit.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficiente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [5 pikë]

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Përcaktimi i këtij kriteri vlerësimi është bërë me qëllim promovimin e praktikave të qëndrueshme gjatë realizimit të kontratës, duke vlerësuar qasjen e operatorëve ekonomikë për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis dhe menaxhimin e aspekteve sociale që lidhen me zbatimin e punimeve.

Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit, realizimi i punimeve mund të shoqërohet me ndikime të përkohshme mjedisore dhe sociale, si rezultat i përdorimit të materialeve, transportit të tyre, funksionimit të makinerive, menaxhimit të mbetjeve, si dhe ndërhyrjeve në akset rrugore ekzistuese.

Nëpërmjet këtij kriteri Autoriteti Kontraktor synon të vlerësojë masat dhe propozimet konkrete të operatorit ekonomik për:

- përdorimin e materialeve me ndikim të reduktuar në mjedis, materialeve të riciklueshme ose me jetëgjatësi më të lartë;
- përdorimin e pajisjeve dhe makinerive eficiente që reduktojnë konsumin e energjisë dhe emetimet;
- menaxhimin dhe kontrollin e mbetjeve të krijuara gjatë procesit të punës;
- marrjen e masave për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes nga pluhurat, zhurmat dhe aktivitetet e kantierit;
- zbatimin e masave për ruajtjen e sigurisë dhe mirëqenies së komunitetit gjatë zhvillimit të punimeve.

a) Propozime për minimizimin e ndikimit mjedisor [5 pikë]

Ky nën-kriter është përcaktuar për të vlerësuar aftësinë e operatorit ekonomik për të paraqitur masa konkrete dhe të zbatueshme për mbrojtjen e mjedisit gjatë ekzekutimit të kontratës.

Vlerësimi i përdorimit të materialeve ekologjike, pajisjeve eficiente dhe planeve të menaxhimit mjedisor synon të sigurojë që punimet të realizohen duke respektuar kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

b) Propozime për ndikimin social dhe ekonominë lokale [5 pikë]

Ky nën-kriter është përcaktuar për të vlerësuar angazhimin e operatorit ekonomik në krijimin e ndikimeve pozitive sociale gjatë zbatimit të kontratës, veçanërisht nëpërmjet mundësive të punësimit dhe përfshirjes së fuqisë punëtore lokale.

Punësimi i personave nga zonat ku do të zhvillohen punimet kontribuon në rritjen e përfitimeve ekonomike lokale, në zhvillimin e komuniteteve përreth dhe në krijimin e një ndikimi social pozitiv nga realizimi i projektit.

Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës dhe nuk zëvendëson kërkesat minimale mjedisore dhe sociale të detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi, por synon të vlerësojë vlerën e shtuar që operatorët ekonomikë propozojnë përtej këtyre kërkesave.

5. Periudha e garancisë së objektit [10 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë së punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vite) [10 pikë]
Kjo, në mbështetje të *Udhëzimit Nr. 3, datë 15.2.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit"*.

Pikët për këtë nënkriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = O_{k1} \times P_{\max k1} / V_{\max k1}$$

$V_{\max k1}$ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Shënim: Operatori ekonomik pjesëmarrës për vlerësimin me pikë për këto dy nënkritere duhet të vetëdeklarojë se do të kryejë edhe mirëmbajtjen rutinë gjatë periudhës së garancisë.

Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kritereve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas Shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

Argumentimi:

Kërkesa për vlerësimin e periudhës së garancisë së punimeve është përcaktuar duke u mbështetur në *Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit"*, si dhe në kuadër të *nenit 45, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, i ndryshuar.

Përcaktimi i këtij kriteri si element vlerësimi është bërë me qëllim nxitjen e operatorëve ekonomikë për të ofruar një periudhë më të gjatë përgjegjësie dhe garantimi për punimet e realizuara, duke siguruar një cilësi më të lartë të zbatimit dhe qëndrueshmëri të investimit publik. Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të kontratës elementët e realizuar (sinjalistika horizontale, vertikale dhe pajisjet e sigurisë rrugore) duhet të ruajnë funksionalitetin, qëndrueshmërinë dhe parametrat teknikë të kërkuar gjatë periudhës së përdorimit.

Vlerësimi i periudhës së garancisë favorizon operatorët ekonomikë që marrin përsipër një angazhim më të lartë për cilësinë e punimeve dhe për korrigjimin e çdo mangësie që mund të shfaqet gjatë periudhës së garancisë, duke ulur riskun për Autoritetin Kontraktor dhe duke garantuar mbrojtjen e interesit publik.

Formula e përcaktuar për vlerësimin e këtij kriteri siguron një vlerësim proporcional të ofertave, duke i dhënë avantazh operatorëve ekonomikë që ofrojnë periudhën më të gjatë të garancisë, në përputhje me parimet e ofertës ekonomike më të favorshme. Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës dhe synon përzgjedhjen e një operatori ekonomik që jo vetëm realizon punimet brenda kërkesave teknike, por garanton edhe qëndrueshmërinë dhe performancën e tyre pas përfundimit të zbatimit të kontratës.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- d. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2;*

Argumentimi:

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar në DST paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, Sigurimit të Ofertës, Formularit të Ofertës dhe Listës së Çmimeve sipas shtojcave përkatëse të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Megjithëse Formulari i Ofertës dhe Lista e Çmimeve janë pjesë përbërëse e DST-ve, përfshirja e tyre në këtë pikë është bërë për qëllime qartësie, transparence dhe administrimi korrekt të procedurës, me synim evidentimin e dokumenteve kryesore që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë në momentin e dorëzimit të ofertës.

Kjo mënyrë formulimi nuk shton kërkesa të reja kualifikimi dhe nuk krijon barriera për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, por shërben vetëm për të rikujtuar detyrimin për paraqitjen e dokumenteve të domosdoshme që garantojnë vlefshmërinë, krahasueshmërinë dhe vlerësimin korrekt të ofertave.

Përvoja e Autoritetit Kontraktor në administrimin e procedurave të prokurimit ka evidentuar raste të mosparaqitjes ose paraqitjes së paplotë të këtyre dokumenteve nga operatorët ekonomikë, çka ka sjellë vështirësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, evidentimi i tyre në mënyrë të veçantë synon vetëm garantimin e paraqitjes së plotë të dokumentacionit të ofertës dhe zhvillimin normal të procedurës së prokurimit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: sipas Shtojcës 8

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e kapacitetit profesional sipas Shtojcës 8 është përcaktuar në mbështetje të Nenit 77, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe Nenit 41, pika 4 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përmes Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, operatori ekonomik deklaron përmbushjen e kërkesave që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë profesionale, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë i shërben verifikimit paraprak të aftësisë profesionale të operatorëve ekonomikë për të ushtruar ligjërisht aktivitetin objekt prokurimi dhe është në përputhje me natyrën e kontratës dhe kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga këto vite të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, është vendosur në përputhje me natyrën, vlerën dhe përmasat e kontratës.

Ky kriter synon të provojë se operatori ekonomik disponon kapacitet të mjaftueshëm ekonomik dhe financiar për të realizuar kontratën brenda afatit prej 8 muajsh, duke garantuar furnizimin me materiale, mobilizimin e burimeve njerëzore dhe teknike, si dhe përballimin e fluksit financiar të nevojshëm gjatë ekzekutimit të punimeve.

Kërkesa është në përputhje me objektin dhe fondin limit të procedurës, nuk kufizon konkurrencën dhe i jep mundësi operatorëve ekonomikë që kanë pasur aktivitet ekonomik të mjaftueshëm gjatë njërit prej tre viteve të fundit financiare të marrin pjesë në procedurë.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** (Bilancet të parqiten konform parashikimit të *Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 është vendosur në mbështetje të *Nenit 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar*, si dhe *Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar*.

Ky kriter synon të verifikojë gjendjen ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë, si dhe aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga realizimi i kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin punë publike, realizimi i kontratës kërkon një gjendje financiare të qëndrueshme, e cila garanton aftësinë e operatorit ekonomik për të siguruar materialet e nevojshme, makineritë dhe pajisjet e ndërtimit, fuqinë punëtore, si dhe për të përballuar shpenzimet operative gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Kërkesa që bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme të mos paraqesin raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit është vendosur për të provuar një aktivitet ekonomik të qëndrueshëm dhe një gjendje financiare të shëndoshë të operatorit ekonomik, duke minimizuar rrezikun e vështirësive financiare gjatë ekzekutimit të kontratës dhe duke garantuar vazhdimësinë normale të punimeve deri në përfundimin e tyre.

Përcaktimi i viteve financiare 2023, 2024 dhe 2025 është bërë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe kontabël në fuqi, referuar *Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjit nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar*, si dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilat përcaktojnë detyrimin për hartimin dhe depozitim të pasqyrave financiare vjetore.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale për sa i përket aftësisë teknike e profesionale.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera**, e marrë së bashku gjatë **pesë viteve të fundit**, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.3.1/1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular Vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
 - Aktin e kolaudimit

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
 - Akt kolaudimi objekti

Shënim: *Vërtetimi duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

2.3.1/2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit;

2.3.1/3 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e dëshmive që vërtetojnë realizimin me sukses të punëve të ngjashme është vendosur në përputhje me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, si dhe në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik për kualifikimin e operatorëve ekonomikë.

Objekti i kësaj kontrate përfshin realizimin e punimeve për përmirësimin e sinjalistikës horizontale, sinjalistikës vertikale dhe instalimin e pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Verior, punime që kërkojnë njohuri teknike, organizim të mirë të proceseve të punës, përdorimin e pajisjeve specifike dhe respektimin e standardeve teknike për sigurinë rrugore.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë të provojnë se kanë realizuar më parë punime të ngjashme:

- për një kontratë të vetme me vlerë jo më të vogël se 50% e fondit limit, ose
- për disa kontrata, me vlerë totale jo më të vogël se dyfishi i fondit limit,

të realizuara gjatë pesë viteve të fundit.

Ky kriter garanton që operatori ekonomik disponon eksperiencën e nevojshme teknike dhe organizative për realizimin me cilësi dhe brenda afatit të kontratës, duke minimizuar rrezikun e mosrealizimit ose realizimit me mangësi të punimeve. Dokumentacioni i kërkuar (formulari i vlerësimit, kontrata, situacioni përfundimtar, faturat tatimore dhe akti i kolaudit për kontratat publike, si dhe dokumentacioni përkatës për kontratat private) është i domosdoshëm për të provuar jo vetëm ekzistencën e kontratës, por edhe realizimin e saj me sukses, vlerën e punimeve të kryera dhe përputhshmërinë e tyre me objektin e prokurimit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe të nënkontraktimit, kërkesat për paraqitjen e dokumentacionit përkatës janë vendosur për të mundësuar verifikimin e pjesës konkrete të punimeve të realizuara nga secili operator, duke garantuar se eksperiencia e deklaruar është reale, e verifikueshme dhe në përputhje me pjesëmarrjen e secilit në realizimin e kontratave të mëparshme.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

2.3.2/1 Kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-11-A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja të TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
2	NP-12-A	Punime të inxhinierisë së mjedisit
3	NS-6-D	Sinjalistika rrugore jondricuese
4	NS-7-A	Barriera dhe mbrojtja rrugore
5	NS-18-A	Punime topogjeodezike

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e licencës profesionale të shoqërisë, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, është vendosur në përputhje me legjislacionin në fuqi për veprimtarinë e ndërtimit dhe është e domosdoshme për të garantuar që operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht dhe disponon kapacitetet profesionale për realizimin e punimeve objekt prokurimi.

Objekti i kontratës përfshin punime të specializuara të infrastrukturës rrugore, të cilat kërkojnë zotërimin e kategorive përkatëse të licencës profesionale, sipas përcaktimeve të VKM nr. 42, datë 16.01.2008.

Kategoritë e kërkuara janë në përputhje me natyrën e punimeve që do të realizohen, konkretisht:

- **NP-11-A (Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja të TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)** – kërkohet për shkak të natyrës së punimeve objekt

kontrate, të cilat përfshijnë elementë që lidhen me instalimet dhe furnizimin me energji elektrike. Kjo kategori licence garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e këtyre punimeve në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe kërkesat e sigurisë në fuqi.

- **NP-12/A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)** – kërkohet pasi gjatë zbatimit të punimeve do të kryhen ndërhyrje në mjedisin rrugor dhe në elementët përbërës të tij, duke garantuar zbatimin e punimeve sipas standardeve teknike dhe mjedisore.
- **NS-6/D (Sinjalistika rrugore jondriçuese)** – është kategoria kryesore e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi përfshin furnizimin dhe vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale jondriçuese.
- **NS-7/A (Barriera dhe mbrojtja rrugore)** – kërkohet për realizimin e punimeve që lidhen me vendosjen, zëvendësimin ose rehabilitimin e barrierave mbrojtëse dhe pajisjeve të tjera të sigurisë rrugore, të cilat janë pjesë e objektit të kontratës.
- **NS-18/A (Punime topogjeodezike)** – kërkohet për kryerjen e matjeve, piktimit dhe verifikimeve topografike që nevojiten për pozicionimin e saktë të sinjalistikës dhe elementëve të sigurisë rrugore, në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike.

Kërkimi i këtyre kategorive të licencës është në raport të drejtë me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës dhe synon të garantojë që punimet do të realizohen nga operatorë ekonomikë të licencuar dhe të kualifikuar për këtë lloj veprimtarie, duke respektuar standardet teknike dhe kërkesat ligjore në fuqi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-11-A	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja të TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Punime elektrike	0-20 milion	13,525,150.58
NP-12/A	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Punime pastrim asfalti dhe reaksionet kimike të bojrave	0-20 milion	18,744,193.34

NS-6/D	Sinjalistika rrugore jondriçuese	Punime sinjalistike vertikale dhe horizontale	101-200 milion	187,441,933.48
NS-7-A	Barriera dhe mbrojtja rrugore	Vendosje guardrail, new jersey, parmakë.	0-20 milion	2,104,913.10
NS-18-A	Punime topogjeodezike	Punime në trupin e rrugës	0-20 milion	13,525,150.58

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (një) Inxhinier Topograf / Gjeodet / Markshajder**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**

*** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar

me VKM Nr. 545, datë 04.09.2024), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për disponimin e personelit kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, është vendosur në përputhje me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e punimeve objekt prokurimi, me qëllim garantimin e realizimit të kontratës sipas projektit, specifikimeve teknike dhe standardeve në fuqi për sigurinë rrugore. Objekti i kontratës përfshin punime për përmirësimin e sinjalistikës horizontale, sinjalistikës vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore në akset e Rajonit X, të cilat kërkojnë drejtim teknik nga specialistë të fushave përkatëse.

Për këtë arsye kërkohet që operatori ekonomik të disponojë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**, i cili do të jetë përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e punimeve, zbatimin e projektit, respektimin e specifikimeve teknike, cilësinë e punimeve dhe koordinimin teknik gjatë realizimit të kontratës.
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**, i nevojshëm për mbikëqyrjen e punimeve që lidhen me montimin dhe instalimin e barrierave mbrojtëse metalike, pajisjeve të sigurisë rrugore dhe elementëve të tjerë metalikë që janë pjesë e objektit të kontratës.
- **1 (një) Inxhinier Mjedis**, i nevojshëm për monitorimin e zbatimit të masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë realizimit të punimeve, administrimin e mbetjeve që krijohen gjatë ndërhyrjeve dhe respektimin e kërkesave mjedisore të parashikuara në dokumentacionin teknik dhe legjislacionin në fuqi.
- **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder**, i nevojshëm për kryerjen e matjeve topografike, piktimin, verifikimin e koordinatave dhe pozicionimin e saktë të sinjalistikës horizontale, vertikale dhe pajisjeve të sigurisë rrugore, sipas projektit të zbatimit.
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**, i nevojshëm për ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të punimeve që lidhen me instalimet elektrike dhe elementët e furnizimit me energji, duke garantuar realizimin e tyre në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe kërkesat e sigurisë në fuqi.

Kërkimi i këtij stafi teknik është në përpjesëtim me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës dhe synon të garantojë realizimin e punimeve me cilësi, brenda afatit kontraktor dhe në përputhje me standardet teknike të sigurisë rrugore.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës së punës, diplomës, librezës së punës, CV-së dhe dokumentacionit që vërteton sigurimin e drejtuesve teknikë, shërben për të provuar disponueshmërinë, kualifikimin profesional dhe angazhimin real të personelit që do të jetë përgjegjës për zbatimin e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht **45 (dyzet e pesë) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për muajin **Maj 2026**, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin **Maj 2026**.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin **Maj 2026**.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024, datë 08.02.2024) në të cilin thuhet: *“Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohë është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim **të paktën 30 persona**, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike jane bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (materiale, punëtori, makineri, transport) zëri i fuqisë punëtore zë rreth 20% të kostos.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores ”Për sigurinë në kantier”.

1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si **“Auditues/Insepektues i Sigurisë Rrugore”** (auditin e sigurisë rrugore dhe menaxhimin e pikave të zeza)” lëshuar nga Institucionet Kompetente Shtetërore në përputhje me klauzolat e Direktivës 2008/96/EC ose ekuivalente.

**** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.*

****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Certifikatë/Diplomë, Librezë pune. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 6, shkronja "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar këtë kriter me qëllim që operatorët ekonomikë të provojnë se disponojnë personelin e specializuar dhe të kualifikuar, të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Objekti i kontratës përfshin punime që do të realizohen në akse rrugore në funksion, ku zhvillohet qarkullim i mjeteve dhe përdoruesve të rrugës. Për këtë arsye, gjatë zbatimit të punimeve duhet të garantohen njëkohësisht siguria e punonjësve, siguria e përdoruesve të rrugës dhe respektimi i standardeve teknike të sigurisë rrugore.

Në këtë kuadër, kërkesa për disponimin e:

- **1 (një) punonjësi të pajisur me certifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave";**
- **1 (një) punonjësi me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë";**
- **1 (një) punonjësi me certifikatë "Auditues/Inspektues i Sigurisë Rrugore";**

është në përpjesëtim me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës.

Kërkesa për specialistin e sigurisë dhe mbrojtjes në punë mbështetet në Ligjin nr. 10327, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", si dhe në VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier"", ku përcaktohet detyrimi i punëdhënësit për marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëmarrësve, si dhe për caktimin e personave përgjegjës për ndihmën e parë, emergjencat dhe zbatimin e masave parandaluese në kantier.

Po kështu, kërkesa për ekspertin e ndihmës së parë dhe ndërhyrjes ndaj emergjencave është e nevojshme për të garantuar reagim të menjëhershëm në rast aksidentesh ose situatash të paparashikuara gjatë ekzekutimit të punimeve, duke minimizuar rrezikun për jetën dhe shëndetin e punonjësve dhe përdoruesve të rrugës.

Lidhur me specialistin **Auditues/Inspektues i Sigurisë Rrugore**, kërkesa mbështetet në dispozitat e nenit 71/1 të Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor, miratuar me VKM nr. 815, datë 23.11.2011, sipas të cilit auditimi i sigurisë rrugore përbën kontroll të pavarur dhe sistematik të projekteve të ndërtimit, rehabilitimit dhe sinjalizimit rrugor, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e elementëve që mund të krijojnë rrezik për aksidente rrugore. Auditimi është pjesë përbërëse e procesit të projektimit dhe zbatimit të punimeve dhe shërben si mbështetje për autoritetin pronar të rrugës, projektuesin dhe zbatuesin e punimeve.

Duke qenë se objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e elementëve të sigurisë rrugore, si sinjalistika horizontale, sinjalistika vertikale dhe pajisjet mbrojtëse, prania e këtij specialisti konsiderohet e nevojshme për të garantuar që zbatimi i punimeve të jetë në përputhje

me standardet teknike të sigurisë rrugore dhe të kontribuojë në rritjen e sigurisë së përdoruesve të rrugës.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës së punës, certifikatës/diplomës dhe dokumentacionit përkatës për secilin specialist synon të verifikojë disponueshmërinë reale dhe kualifikimin profesional të personelit që do të angazhohet në realizimin e kontratës.

Gjithashtu, kërkesa që ky staf të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera apo i deklaruar në procedura të tjera të shpallura fituese është vendosur me qëllim garantimin e disponueshmërisë efektive të specialistëve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, duke shmangur mbivendosjen e angazhimeve dhe duke siguruar realizimin e punimeve në përputhje me afatet dhe cilësinë e kërkuar.

2.3.6 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik të punimeve** (*Inxhinier Ndërtimi*) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe **nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

*“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: **Diplomë, librezë pune dhe kontratë pune.***

**** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të specifikojë stafin e propozuar duke përshkruar qartë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.8, pikën e kriterit dhe pozicionin që do përmbushi ky staf.*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 6, shkronja "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponimin e personelit teknik të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Duke marrë në konsideratë natyrën, volumin dhe kompleksitetin e punimeve objekt kontrate është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë një **Drejtues Teknik të Punimeve**, me profil **Inxhinier Ndërtimi**, i cili do të jetë përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin teknik të punimeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Drejtuesi Teknik i Punimeve do të sigurojë:

- organizimin dhe drejtimin teknik të proceseve të punës në objekt;
- kontrollin e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet në fuqi;
- koordinimin ndërmjet personelit teknik, fuqisë punëtore dhe mjeteve të angazhuara në realizimin e kontratës;
- kontrollin e cilësisë së punimeve dhe respektimin e afateve kontraktore;
- bashkëpunimin me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Kërkesa që Drejtuesi Teknik të jetë i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë është vendosur me qëllim garantimin se personi i propozuar disponon kualifikimin dhe autorizimin profesional të nevojshëm për drejtimin teknik të punimeve, në përputhje me kërkesat ligjore për ushtrimin e veprimtarisë së ndërtimit.

Kërkesa për praninë e vazhdueshme të Drejtuesit Teknik gjatë realizimit të punimeve është e nevojshme për shkak të karakteristikave të objektit, i cili përfshin ndërhyrje në akse rrugore aktive dhe kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme teknike, marrje vendimesh në kohë reale dhe garantimin e zbatimit korrekt të punimeve.

Kushti që Drejtuesi Teknik të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera ose në procedura të shpallura fituese është vendosur për të garantuar disponueshmërinë reale të këtij personeli gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të kontratës dhe për të shmangur mbivendosjen e angazhimeve që mund të ndikojnë në cilësinë dhe ecurinë e punimeve.

Kërkesa për paraqitjen e diplomës, librezës së punës dhe kontratës së punës synon të verifikojë kualifikimin profesional, eksperiencën dhe marrëdhënien reale të punësimit të personit të propozuar si Drejtues Teknik i Punimeve.

Ky kriter është proporcional me natyrën dhe objektin e kontratës dhe synon të garantojë që punimet të realizohen nga një operator ekonomik që disponon kapacitetet profesionale dhe organizative të nevojshme për përmbushjen e kërkesave të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamionçinë	2 copë	Pronësi ose me qira
Kamion me vinç të integruar	1 copë	Pronësi ose me qira
Kompresor (i lëvizshëm)	1 copë	Pronësi ose me qira
Karrel për sinjalizimin e punimeve në rrugë	2 copë	Pronësi ose me qira
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qira
Automjet Vijëzimi (APV me leje qarkullimi) me bojë termoplastike	1 copë	Pronësi ose me qira
Makineri vijëzimi me bojë bikomponente	1 copë	Pronësi ose me qira
Set semaforësh për kontrollin e trafikut	1 copë	Pronësi ose me qira
Mjet fshese për pastrimin e asfaltit	1 copë	Pronësi ose me qira
Mjet freze për heqjen e vijave ekzistuese	1 copë	Pronësi ose me qira
Makineri për vendosje guardrail	1 copë	Pronësi ose me qira

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 të Nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018).

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 *Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:*

- SSH EN ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- SSH EN ISO 14001:2016 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën që operatorët ekonomikë të paraqesin certifikata të sistemeve të menaxhimit, me qëllim garantimin e kapaciteteve të tyre për realizimin e punimeve sipas standardeve të kërkuara të cilësisë, mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë në punë.

Objekti i kontratës përfshin punime që realizohen në infrastrukturën rrugore aktive dhe që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e përdoruesve të rrugës. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë sisteme të organizuara menaxhimi, të cilat garantojnë kontrollin e proceseve të punës, përdorimin e materialeve sipas kërkesave teknike dhe zbatimin e masave parandaluese gjatë ekzekutimit të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatave të mëposhtme është vendosur në raport me natyrën e punimeve që do të realizohen:

- **SSH EN ISO 9001:2015 – Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë**, kërkohet me qëllim garantimin se operatori ekonomik disponon një sistem të dokumentuar për kontrollin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të punës, menaxhimin e cilësisë dhe realizimin e punimeve në përputhje me kërkesat teknike dhe kontraktore.
- **SSH EN ISO 14001:2026 – Sistemet e Menaxhimit Mjedisor**, kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik zbaton procedura të menaxhimit të ndikimeve mjedisore gjatë zhvillimit të punimeve, përfshirë menaxhimin e mbetjeve, parandalimin e ndotjes dhe respektimin e kërkesave ligjore për mbrojtjen e mjedisit.
- **SSH EN ISO 45001:2023 – Sistemet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë**, kërkohet për shkak të natyrës së punimeve në akse rrugore ku ekzistojnë rreziqe të veçanta për punonjësit dhe përdoruesit e rrugës, me qëllim garantimin e një sistemi të kontrolluar për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vendin e punës.

Kërkesa që certifikatat të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizma kombëtarë ose ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, synon të garantojë vlefshmërinë dhe besueshmërinë e dokumentacionit të paraqitur.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të paraqesë certifikatat përkatëse sipas zërave të punimeve që do të realizojë është vendosur me qëllim që çdo operator ekonomik të provojë se disponon sistemet e menaxhimit dhe kapacitetet organizative për pjesën konkrete të kontratës që do të marrë përsipër.

Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës dhe shërben për të garantuar që punimet do të realizohen në mënyrë të kontrolluar, me cilësi të lartë, duke respektuar kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e shëndetit në punë.

2.4.2 Grafiku i punimeve.

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e grafikut të punimeve është përcaktuar bazuar në nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024, si dhe nenin 39, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Paraqitja e grafikut të punimeve synon të evidentojë mënyrën e organizimit dhe planifikimit të realizimit të kontratës nga operatori ekonomik, duke garantuar që punimet do të zhvillohen në mënyrë të koordinuar dhe brenda afatit të përcaktuar kontraktor.

Duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të kontratës, si dhe faktin që punimet do të realizohen në akse rrugore ekzistuese ku duhet të garantohet vijimësia e qarkullimit dhe siguria e përdoruesve të rrugës, është e nevojshme që operatori ekonomik të paraqesë një planifikim të qartë të proceseve të punës. Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për të vlerësuar nëse operatori ekonomik ka një qasje të strukturuar dhe të realizueshme për përmbushjen e detyrimeve kontraktore, duke ulur rrezikun e vonesave dhe të mosrealizimit të punimeve sipas kërkesave teknike.

Kërkesa për paraqitjen e grafikut të punimeve është proporcionale me objektin dhe kompleksitetin e kontratës, pasi realizimi i punimeve të sinjalistikës dhe pajisjeve të sigurisë rrugore kërkon koordinim të mirë të proceseve të punës, furnizimeve, mjeteve dhe personelit të angazhuar.

2.4.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).*

Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe te pika 2.10 e DST-ve. Financimi është parashikuar në buxhetin për vitet 2026-2028.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar).

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e deklaratës nga operatori ekonomik ofertues, nëpërmjet së cilës shprehet dakordësia për mënyrën e financimit të objektit dhe angazhimi për përfundimin e punimeve brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, është vendosur me qëllim garantimin e realizimit të kontratës në përputhje me kushtet kontraktore dhe planifikimin financiar të miratuar.

Burimi i financimit për këtë procedurë është **Buxheti i Shtetit**, i përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit në pikën 2.10, me financim të parashikuar për vitet **2026-2028**. Për shkak të natyrës së financimit publik dhe shpërndarjes së tij ndër vite buxhetore, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të deklarojnë paraprakisht pranimin e mënyrës së financimit dhe angazhimit të tyre për realizimin e punimeve brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kjo deklaratë synon të garantojë që operatori ekonomik ofertues ka njohuri dhe pranon kushtet financiare të realizimit të kontratës, si dhe disponon kapacitetet e nevojshme organizative dhe financiare për të përballuar zbatimin e punimeve sipas grafikut dhe afatit kontraktor, pavarësisht shpërndarjes së financimit në disa vite buxhetore.

Gjithashtu, kërkesa lidhet me nevojën për të siguruar angazhimin e operatorit ekonomik për përfundimin e objektit brenda afatit të përcaktuar, duke shmangur vonesat në realizimin e punimeve dhe duke garantuar përdorimin efektiv të fondeve publike.

Ky kriter është proporcional me natyrën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi kërkon vetëm deklarin e pranimin të kushteve të financimit dhe të afatit të realizimit të punimeve, të cilat janë të përcaktuara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e procedurës.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të

*punës, në përputhje me parashikimet e Nenit 4, pika 38/b dhe Nenit 36, të LPP (i ndryshuar me Ligjin Nr. 16/2024), si dhe nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP (i ndryshuar). Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në çdo rast nëse janë përmendur markë prodhimi ose proces i veçantë pranohen edhe ekuivalent.

Specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë hartuar nga projektuesi në përputhje me natyrën, qëllimin dhe kërkesat funksionale të objektit të prokurimit, me qëllim garantimin e realizimit të punimeve sipas standardeve teknike të kërkuara për infrastrukturën rrugore dhe sigurinë e përdoruesve të rrugës.

Përcaktimi i specifikimeve teknike është bazuar në:

- projektin e zbatimit dhe preventivin e punimeve;
- kushtet teknike të zbatimit për punimet rrugore;
- standardet shqiptare dhe/ose standardet evropiane të zbatueshme;
- kërkesat ligjore dhe teknike në fuqi për sinjalistikën rrugore dhe pajisjet e sigurisë rrugore.

Specifikimet teknike janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të përshkruajnë kërkesat minimale funksionale, cilësore dhe teknike që duhet të plotësojnë materialet dhe punimet, duke garantuar:

- dukshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sinjalistikës horizontale dhe vertikale;
- rezistencën mekanike dhe jetëgjatësinë e elementëve të sigurisë rrugore;
- përdorimin e materialeve të përshatshme për kushtet e përdorimit në akset rrugore;
- zbatimin e punimeve në përputhje me kërkesat e sigurisë rrugore dhe mbrojtjes së përdoruesve të rrugës.

Në hartimin e specifikimeve teknike është respektuar parimi i konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke shmangur përcaktimin e markave, prodhuesve,

burimeve specifike të furnizimit ose kërkesave që mund të favorizojnë një operator ekonomik të caktuar. Çdo kërkesë teknike është vendosur mbi bazën e performancës, funksionalitetit dhe standardeve që duhet të përmbushë produkti ose punimi.

Për shkak të natyrës së kontratës, ku ndërhyrjet kryhen në akse rrugore ekzistuese dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e qarkullimit rrugor, specifikimet teknike janë të domosdoshme për të garantuar që materialet, pajisjet dhe metodat e zbatimit të jenë të përshtatshme për përdorim afatgjatë dhe të përmbushin kërkesat e cilësisë dhe sigurisë.

Në këtë mënyrë, specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor janë proporcionale me objektin e prokurimit dhe synojnë sigurimin e një realizimi cilësor të kontratës, duke garantuar njëkohësisht konkurrencë të drejtë dhe akses të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë të aftë për realizimin e punimeve.